




EDUKIMI INKLUZIV / GJITHËPËRFSHIRËS

Trajnim për mësimdhënës


Instituti për Kërkim, Edukim dhe Zhvillim Social (IREDS) organizon trajnimin për mësimdhënës në fushën e **edukimit inkluziv**. Ky trajnim u ofron mësimdhënësve një perspektivë të trendeve të fundit në zhvillimin e arsimit parauniversitar, në të cilin kanë filluar reformat e mësimin inkluziv në shkollat dhe klasat e kombinuara. Me këtë rast, trajnimi fokusohet në përgatitjen e mësimdhënësve me njohuri dhe shkathtësi të reja në vlerësimin e ambientit shkollor dhe klasës për adaptim në shkollë/klasë inkluzive. Trajnimi poashtu fokusohet edhe në njohje të vështirësive të ndryshme të të nxënës të shfaqur tek fëmijët në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, si dhe rreth qasjeve të intervenimit në klasë dhe shkollë tek fëmijët me vështirësi në të nxënë. Programi i trajnimit i ka katër module:

1. Konceptet në Edukimin Inkluziv;
2. Shkolla inkluzive / vlerësimi dhe modelimi i shkollës inkluzive;
3. Fëmijët me nevoja të veçanta, vështirësi në të nxënë dhe edukimi i tyre;
4. Zhvillimi i kurrikulave dhe didaktika në edukimin inkluziv / Plani Individual i Arsimit (PIA);

Programi i trajnimit është akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i ofron 80 orë, të cilat u njihen mësimdhënësve për (ri)licencim.



Programi i akredituar nga MASHT



Programi i trajnimit ofron 80 orë trajnim.

Pjesëmarrës për këtë trajnim janë të gjithë mësimdhënësit që punojnë në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë.

Pjesëmarrësit e regjistruar do të informohen me kohë për vendin dhe programin e trajnimit.

Na kontaktoni për të bërë rezervimin për trajnim!

Instituti për Kërkim, Edukim dhe Zhvillim Social - IREDS

Mehsini Prishtinasi, p.n.
10000 Prishtinë

Tel: +383 44 661 517

Email: ireds.ks@gmail.com

www.ireds-ks.org

Ekipi i trajnimit



Bujar Gallopeni, MSc. PhD(c)

Aktualisht është kandidat për doktoraturë në shkencat e psikologjisë në Universitetin Sheffield në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa studimet Master i ka përfunduar në Universitetin e Maastricht-it, Holandë, në fushën e Psikologjisë së Punës dhe Organizatave.

Ai ka përvojë të gjërë pune në institucionet e arsimit të lartë në ligjërime, zhvillim të programeve studimore, zhvillim të projekteve dhe proceseve tjera akademike (Universiteti i Prishtinës, Kolegji UBT, Kolegji Heimerer, dhe aktualisht Kolegji Nderkombëtarë i Biznesit në Mitrovicë - IBCM). Poashtu, ai ka një përvojë të konsiderueshme në sektorët qeveritarë dhe joqeveritarë, duke përfshirë edhe përvojën që është arritur duke punuar për pesë vite në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në hartimin dhe zbatimin e politikave strategjike dhe legjislativ arsimore.

Ka përvojë të gjatë në ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe personelit shkollor. Është i validuar nga Këshilli Britanik si trajner për drejtorë dhe mësimdhënës, në programin e Shkollave të Shekullit 21, i cili fokusohet në metodologjinë shkollore dhe mësimdhënies në zhvillimin e shkathtësive të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve (MKZP), duke përfshirë edhe kodimin përmes micro: bit. Deri tani ka mbajtur shumë trajnime në MKZP, edukimin inkulziv, dhe metoda të mësimdhënies dhe vlerësimit.



Florim Gallopeni, MSc. PhD(c)

Florim Gallopeni studimet bazike kreu në Universitetin e Prishtinës në Fakultetin Filozofik, Departamenti i Psikologjisë dhe pastaj vazhdoi me studimet Master në Psikologjinë Klinike përmes Projektit të TEMPUS-it. Aktualisht Florim Gallopeni është në studimet e doktoratës në universitetin University Autonoma de Barcelona në drejtimin Psikologji Klinike dhe Shëndetësore.

Florim Gallopeni ka përvojë në mësimdhënie në institucionet e arsimit të lartë që nga viti 2010, përvojë të gjatë pune në institucione të ndryshme, Psikolog Klinik në Institutin ATOMI, që nga viti 2011, Psikolog Klinik në institucione të trajtimit të fëmijëve me Autizëm, Psikolog në Fondacioni Together, Psikolog në mbështetjen e familjeve strehuese në qendrat për punë sociale përmes Amici Dei Bambini, National Supervisory Psychologist at Mensa Kosovo, dhe angazhime të tjera në projekte të ndryshme hulumtuese dhe profesionale.

Florim Gallopeni ka marrë pjesë në shumë konferenca vendore dhe ndërkombëtare me prezantime Poster dhe prezantime Orale, po ashtu ka publikuar disa punime shkencore në revista me renome në botë, së fundmi Florim Gallopeni është edhe Reviewer në revistat e Elsevier.



Arben Hysenaj, MSc. PhD(c)

Arben Hysenaj aktualisht është Kandidat për doktoratë në Universitetin e Bambergut – Otto Friedrich University of Bamberg – në Gjermani. Drejtimi i studimeve është Psikologjia Klinike dhe shëndetsore, saktësisht fusha e studimit është Migrimi dhe Shëndeti Mendor.

Nivelin e studimeve Master dhe Bachelor i ka të përfunduara në Universitetin Hasan Prishtina, Kosovë.

Ai ka përvojë pune të larmishme si në Institucionet Arsimore të mesëm dhe të larta si dhe në projekte të ndryshme. Cilësohet me përvojën e tij në mësimdhënie dhe në Ligjërime në institucionet e arsimit të mesëm të lartë si dhe në programe të ndryshme ligjëruese në kuadër të projekteve të ndryshme. Po ashtu, ai ka një përvojë të konsiderueshme në **sektorët** joqeveritarë, duke përfshirë përvojën që është arritur duke punuar për dhjetë vite rresht si psikolog klinikë në fushën e re integrimit të të kthyerve nga vendet evropiane dhe ballkanike.

Po ashtu dallohet me eksperiencë të ndryshme në fushën e zhvillimit dhe zbatimit të rregulloreve operative dhe strategjive funksionale të projekteve. Ka eksperiencë të mjaftueshme në promovimin dhe rrjetëzimin e bashkëpunimeve dypalësh dhe shumëpalësh midis vendeve **dhe** institucioneve çoftë vendore dhe ndërkombëtare, po ashtu edhe në promovimin e programeve vendore dhe ndërkombëtare në fushën përkrahëse Psiko-sociale. Arben Hysenaj është Reviewer në revistën shkencore me renome botërore Psychology Trauma: Theory, Research, Practice, and Policy.